



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 16 mars 2016, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Abdyl Imeri.

Munguan: Besnik Bislimi, Fikrim Damka, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Artan Venhari – ZAP, Florina Merovci – ZPRK, Kosovare Maliqi – Rrokum Tv, Fjolla Uka – KDI, Dibran Istrefi – KLAN KOSOVA, Fitore Berisha – ZPRK, Blerta Bejtullahu – EUSR/EU Office.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 03.02.2016;
3. Shqyrtimi i Vendimit me propozim të znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, për kandidatin për kryesues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.
4. Të ndryshme;

Zv. Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zv. Kryetari- konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 03.02.2016

Zv. Kryetari- konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 03.02.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Vendimit me propozim të znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, për kandidatin për kryesues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Zv. Kryetari- në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, procedurat për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm udhëhiqen nga Zyra e Presidentes. Zyra e Presidentes në bazë të kompetencave që ka, ka bërë shpalljen e një paneli zgjedhor për kryesues dhe në harmoni me të ka formuar një komision prej disa institucioneve kyçe, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga Kuvendi, Banka Qendrore, Rektorati, Shoqërisë Civile të cilët kanë bërë intervistimin e kandidatëve dhe i kanë propozua tre kandidat Zyrës së Presidentes, për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm.

Në bazë të ligjit Presidentja nga tre kandidatët, i ka propozuar një kandidatë Kuvendit të Kosovës që është z.Besnik Osmani, i cili do të votohet nga Kuvendi dhe i duhen 61 vota të deputetëve për t'u zgjedhur Auditor i Përgjithshëm. Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike nuk ka qenë i involvuar në këtë proces dhe nuk ka asnjë ndikim në përzgjedhjen e Auditorit.

Hajdar Beqa- në bazë të shkresës së lendes, mendoj që gjithçka është në përputhje me ligjin dhe kushtetutën, është lëndë e kompletuar dhe pasi që nuk kemi qenë të involvuar si komision në proces, neve vetëm na mbetet ta procedojmë për Kuvend dhe të votohet nga deputetët për zgjedhje të Auditorit të Përgjithshëm.

Zv. Kryetari- deputetet votuan njëzëri për dërgimin e propozimit dhe rekomandimit të Zyrës së Presidentës të Kuvendi për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, njëzëri votoi për Vendimin me propozim të Presidentes dhe të njëjtin e rekomandoi për shqyrtim dhe aprovim në seancë plenare.

4. Të ndryshme

Zv. Kryetari- KMFP vazhdoi punën në një punëtori jashtë objektit të Kuvendit me të gjithë deputetët për të shqyrtuar Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Përfundim

KMFP njëzëri vendosi që të organizojë një punëtori për shqyrtim të projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Mbledhja përfundoi në orën 09:10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu